

VENDIM
Nr.429, datë 8.4.2008

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E MASAVE PËR IMPORTET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet, si më poshtë vijon:

Z. Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

Znj. Anila Jani, Drejtore e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Makroekonomisë në Ministrinë e Financave;

Z. Grigor Gjeçi, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Rurale në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

Z. Genci Muçaj, Drejtor i Promovimit Ekonomik dhe Kulturor në Ministrinë e Punëve të Jashtme;

Znj. Lindita Xhillari, Drejtore e Departamentit Juridik dhe të Shërbimeve në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë;

Z. Genc Çeli, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Anëtarët e komisionit janë kryesisht juristë dhe/ose ekonomistë.

3. Çdo anëtar i komisionit për vlerësimin e masave për importet të shpërblehet me 5 000 (pesë mijë) lekë për pjesëmarrje në mbledhje, por masa e shpërblimit mujor nuk duhet të jetë më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë.

4. Sektori i antidumpingut, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ushtron funksionet e sekretariatit teknik gjatë procesit të hetimit dhe të punës së komisionit për vlerësimin e masave për importet.

5. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha